VENDIM
Nr. 81, datë 10.2.2021

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "RIKUALIFIKIMI I RRUGËS '20 JANARI', BASHKIA DIVJAKË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikualifikimi i rrugës '20 Janari', Bashkia Divjakë".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Divjakë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë "arë", "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 496 943.79 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë shtatëdhjetë e nëntë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 496 943.79 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Divjakë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Divjakë.
8. Bashkia Divjakë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Divjakë.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Divjakë, në bashkëpunim me Bashkinë Divjakë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Divjakë.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Divjakë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Divjakë.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Divjakë dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA E VLERËSIMIT PËR PASURITË PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
"RIKUALIFIKIM I RRUGËS '20 JANARI', BASHKIA DIVJAKË"

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e prekur e truallit ne m2	Çmimi për truall (leke/m^2)	Vlera e truallit	Sip. e prekur e tokës arë në m^2	Çmimi për tokën arë (lekë/m^2)	Vlera e tokës arë	Sipërfaqja e ndërtimit në kartelë	Sip. e ndërtesës sipas faktit (m^2)		Sip. e prekur e ndërtesës (m^2)	Sipërfaqja totale e ndërtesës që shpronësohet (m^2)	Vlera e ndërtesës (lekë)	Vlera e përgjith. e tokës + ndërtesë (lekë)	Gjendja juridike	Statusi Juridik
											Kati shërbim (m^2)							
											Kati përdhe (m^2)	Kati I (m^2)						
1	Loni Prençe	1492	1276/4							27	27	0	27	27	404,869.79	404,869.79	Konfirmim nga ASHK-ja	Nuk ka shënime
2	Ilir Llazar Rrudho Llazar Naun Rrudho	1492	492/68	15	514	7,710.0										7,710.00	Konfirmim nga ASHK-ja	Nuk ka shënime
3	Rudina Llazar Rrudho	1492	492/69	14	514	7,196.0										7,196.00	Konfirmim nga ASHK-ja	Nuk ka shënime
4	Viktor Sotir Sako	1492	490/19				60.0	364.0	21,840.0							21,840.00	Konfirmim nga ASHK-ja	Nuk ka shënime
5	Perikli Thoma Gjeka	1492	490/2				70.0	364.0	25,480.0							25,480.00	Konfirmim nga ASHK-ja	Nuk ka shënime
6	Aleksander Thoma Gjeka	1492	490/3				70.0	364.0	25,480.0							25,480.00	Konfirmim nga ASHK-ja	Nuk ka shënime
7	Josif Loni Prifti	1492	435/7				12.0	364.0	4,368.0							4,368.00	Konfirmim nga ASHK-ja	Nuk ka shënime
SHUMA TOTALE																**496,943.79**		